



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 gusht 2021
Nr. ref.:RK 1830/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI52/21

Parashtrues

Bedrije Rama

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit, E. Rev.nr. 382/2019, të 21 tetorit 2020,
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bedrije Rama nga komuna e Podujevës, të cilën e përfaqëson Rrahman Rama nga Podujeva (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [E. Rev. nr. 382/2019] e 21 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimin e kontestuar parashtruesja e kërkesës e kishte pranuar më 10 dhjetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale), të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 12 mars 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
7. Më 22 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama Hajrizi caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 30 mars 2020, Gjykata e (i) njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe (ii) njoftoi Gjykatën Supreme për kontestimin e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 382/2019] e 21 tetorit 2020 dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
9. Më 19 prill 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore), për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ta njoftojë Gjykatën lidhur me datën kur parashtruesja e kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
10. Më 17 maj 2021, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesën që tregonte se parashtruesja e kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 10 dhjetor 2020.

11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 28 korrik 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Fillimisht, Gjykata sjell në vëmendje që parashtruesja e kërkesës ishte palë në Gjykatë në rastin KI41/16 (Aktvendim për Papranueshmëri i 1 qershorit 2017) në të cilin rast objekt i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [CML. nr. 5/2015] të 17 dhjetorit 2015.

Faktet relevante nga rasti KI 46/16

14. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton që në këtë rast parashtruesja e kërkesës kishte ndjekur dy lloje procedurash të ndryshme, përkatësisht (i) procedurën Administrative, e cila kishte rezultuar me Aktgjykimin [A. nr. 1041/2008] e 31 tetorit 2011, të Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme) dhe (ii) Procedurën Përmbartimore, e cila kishte rezultuar me Aktvendimin [CML. nr. 5/2015] e 17 dhjetorit 2015, të Gjykatës Supreme. Lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe çështjet e trajtuara në procedurat e lartcekura, Gjykata ka vendosur përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin KI41/16, ku kërkesa është deklaruar si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.
15. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton që më 8 korrik 2004, parashtruesja e kërkesës kishte lidhur kontratë me palën e interesuar- Komunën e Podujevës, për shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore në pronësi shoqërore. Në nenin 4 të kësaj kontrate parashihej që palët kontraktuese pajtoheshin që kur ishte e nevojshme të bëjnë shkëputjen e kontratës me qëllim që objekti dhe lokacioni të shfrytëzohen për nevoja të tjera në pajtim me planin urbanistik, apo me vendim tjetër që e zëvendëson këtë plan.
16. Më 6 tetor 2005, Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Podujevës mori vendim [Vendimi nr. 02-1/240-02] sipas të cilit parashtruesja e kërkesës ishte obliguar që të largojë objektin për shkak të punimeve të parapara në rrugë nga Komuna e Podujevës.
17. Bazuar në gjendjen faktike të rastit KI41/16, rezulton që parashtruesja e kërkesës kishte ndjekur edhe dy lloje tjera procedurash, përkatësisht procedurën e konfliktit administrativ dhe procedurën përmbartimore (për të cilat Gjykata kishte vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri të 1 qershorit 2017).

Faktet relevante të rastit konkret

18. Në vijim lidhur me rrethanat e rastit konkret, nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesja e kërkesës më 20 nëntor 2007, kishte parashtruar padi kundër të paditurës-Komunës së Podujevës, për kompensimin e dëmit në shumën prej 5.000€ me kamate ligjore duke filluar prej 14 nëntorit 2007 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit si dhe shpenzimet procedurale. Kjo padi ishte parashtruar si rezultat të pakënaqësisë së parashtrueses së kërkesës për rrënimin e objektit – kioskut.
19. Më 24 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë (në tekstin në vijim: Gjykata Themelore) në çështjen juridike kontestimore të parashtrueses së kërkesës, nxjerr Aktgjykimin [C.nr.311/07] përmes të cilit: (i) Refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, si e pabazuar, me të cilën kishte kërkuar që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e saj dhe të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit të ia paguajë shumën prej 5,000€ me kamatë ligjore duke filluar nga 14 nëntori 2007 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet procedurale; (ii) Obligohet parashtruesja e kërkesës që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguajë shumën prej 25 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
20. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të priset Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
21. Më 9 gusht 2019, Gjykata e Apelit e Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) përmes Aktgjykimit [Ac.nr.1111/2015] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.311/07] e 24 dhjetorit 2014 të Gjykatës Themelore.
22. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për revizion kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy këto aktgjykime të prishen, apo të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar.
23. Më 21 tetor 2020, Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr. 382/2019] refuzoi si të pabazuar Revizionin e parashtrueses së kërkesës, i paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac.nr.1111/201] të 9 gushtit 2019, të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar, i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

25. Në kërkesën e saj para Gjykatës, parashtruesja e kërkesës pretendon që pala e interesuar, përkatësisht Komuna e Podujevës, pa të drejtë ia kanë rrënuar kioskën në të cilën punonte dhe përmes së cilës punë edhe e mbante familjen. Rrjedhimisht sipas parashtrueses përveç dëmit material që Komuna e Podujevës i ka shkaktuar në vlerë prej 5000 Euro, gjithashtu konsiston edhe shkelja e nenit 49 të Kushtetutës, pasi që e njëjta e ka humbur vendin e punës, përmes së cilës ka siguruar jetesën e saj.
26. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që përmes Aktgjykimit të: (i) anulohet Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit; (ii) detyrojë Komunën e Podujevës që të paguajë dëmin në shumën prej 5000 Euro; (iii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, si pasojë e humbjes së punës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve]

1. E drejta e punës garantohej.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]."

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar e cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E. Rev.nr. 382/2019] të 21 tetorit 2020, të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
31. Përveç këtyre kushteve, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkesave kushtetuese, të përcaktuara në rregullin 39 të Rregullores së punës të Gjykatës. Në këtë drejtim, Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

32. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Me saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta

vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

33. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 28 shkurtit 2021; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 279 deri më 308).
34. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
35. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që rrethanat e rastit ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtrueses të kërkesës, në procedurë kontestimore për kompensimin e dëmit material të shkaktuar nga pala e interesuar-Komuna e Podujevës, në vlerën prej 5000 Euro. Gjykata Themelore e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, të paraqitur kundër Komunës së Podujevës. Duke vepruar sipas ankesës përkatëse dhe kërkesës për revizion, Gjykata e Apelit, e të cilën e konfirmon edhe Gjykata Supreme kishin refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës. Parashtruesja e kërkesës, i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar (i) shkelje të nenit 49 të Kushtetutës si rezultat i vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar të së drejtës materiale. Në vijim Gjykata do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës.
36. Gjykata, gjithashtu, vëren se parashtruesja e kërkesës e kishte ndërtuar ankesën e saj kushtetuese mbi shkeljen e pretenduar të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

37. Gjykata thekson se e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit nga neni 49 i Kushtetutës është subjekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës, ku këto të drejta, më tej realizohen në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Pra, garancia kushtetuese për punë, bëhet në pajtim me ligjin, rrjedhimisht përmbajtja e saj nuk përcaktohet më detajisht.
38. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtrueses së kërkesës përkitazi me shkeljen e pretenduar të nenit 49 të Kushtetutës ndërlidhen me pretendimin e saj se ajo e ka humbur punën, si rezultat i rrënimit të kioskës.
39. Sa i përket shkeljeve të së drejtës për punë dhe ushtrim të profesionit me nenin 49 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GjEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
- a) kur parashtruesja e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (Shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42).
40. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, mirëpo e njëjta, nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e nenit 49 të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KI04/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).
41. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës për shkelje nenit 49 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon

kategorisë së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, pasi parashtruesja e kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 28 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani